|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx |
| 2 | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx |
| 3 | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx |
| 4 | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx | xxxxxxxxx |

**REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT**
EMRI : Ing. Bujar MUJA
LICENSA NR : T.1190/1 DATE 30/11/2017

NENSHKRIMI/VULA : ________

Bujar Muja
Digitally signed by Bujar Muja
Date: 2022.09.28 07:36:59 +02'00'

**TEKNOLOGJIA E MATJEVE :** G
Kode per teknologjine e matjeve : T - terren ; Z - zyre ; O - Ortofoto ; G - Gps ; S - Stacion Total ; D - Matje Distancash ;
**PERCAKTIMI I KUFIRIT :** P
Kode per percaktimin e kufirit : P - Perfaqesues i Pronareve ; K - Kufitaret te Gjithe ; KP - Kufitaret Pjeserisht ; PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale
**SHENIME TE VECANTA :** KUFIT U TREGUAN NGA PERFAQSUESIT E ATURITETIT PORTUAL DURRES NE TERREN

**PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET**
EMRI :________
NENSHKRIMI/VULA : ________

Kode per teknologjine e matjeve dhe per percaktimin e kufirit : T - terren ; Z - zyre ; O - Ortofoto ; G - Gps ; S - Stacion Total ; D - Matje Distancash ; P - Perfaqesues i Pronareve ; K - Kufitaret te Gjithe ; KP - Kufitaret Pjeserisht ; PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

**KERKUESI** Autoriteti portual i Durresit **DATE** 28/09/2022 **QELLIMI** Regjistrim ASHK

**VENDODHJA**
BASHKIA Durres DVASHK Durres ZONA KADASTRALE 8514 NR. PASURISE ________ VOL ____ FQ ____ INDEKSI HARTES DR; M-7

**TE DHENAT E PASURISE**
LLOJI I PASURISE ________ SIP. PASURIE 891 $m^2$ SIP. GJURMES SE NDERTIMIT ________ NR. I KATEVE ____ NR I PEMEVE ________

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE




SH 1:500

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI I KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX |
| 2 | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX |
| 3 | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX |
| 4 | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX |

**REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT**
EMRI : Ing. Bujar MUJA
LICENSA NR : T.1190/1 DATE 30/11/2017

NENSHKRIMI/VULA : ________

Bujar Muja
Digitally signed by Bujar Muja
Date: 2022.09.28 07:37:00 +02'00'

**TEKNOLOGJIA E MATJEVE :** G
Kode per teknologjine e matjeve : T - terren ; Z - zyre ; O - Ortofoto ; G - Gps ; S - Stacion Total ; D - Matje Distancash ;
**PERCAKTIMI I KUFIRIT :** P
Kode per percaktimin e kufirit : P - Perfaqesues i Pronareve ; K - Kufitaret te Gjithe ; KP - Kufitaret Pjeserisht ; PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale
**SHENIME TE VECANTA :** KUFIT U TREGUAN NGA PERFAQSUESIT E ATURITETIT PORTUAL DURRES NE TERREN

**PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET**
EMRI : ________
NENSHKRIMI/VULA : ________

Kode per teknologjine e matjeve dhe per percaktimin e kufirit : T - terren ; Z - zyre ; O - Ortofoto ; G - Gps ; S - Stacion Total ; D - Matje Distancash ; P - Perfaqesues i Pronareve ; K - Kufitaret te Gjithe ; KP - Kufitaret Pjeserisht ; PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

**KERKUESI** Autoriteti portual i Durresit **DATE** 28/09/2022 **QELLIMI** Regjistrim ASHK

**VENDODHJA**
BASHKIA Durres DVASHK Durres ZONA KADASTRALE 8514 NR. PASURISE________VOL____FQ_____ INDEKSI HARTES DR; K8,K9, L-8
**TE DHENAT E PASURISE**
LLOJI I PASURISE ________ SIP. PASURIE 5216 $m^2$ SIP. GJURMES SE NDERTIMIT _______ NR. I KATEVE _____ NR I PEMEVE ________

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE




SH 1:500

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI I KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX | XXXXXXXXX |

**REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT**
EMRI : Ing. Bujar MUJA
LICENSA NR : T.1190/1 DATE 30/11/2017

NENSHKRIMI/VULA : ________

Bujar Muja Digitally signed by Bujar Muja Date: 2022.09.28 07:36:59 +02'00'

**TEKNOLOGJIA E MATJEVE :** G
Kode per teknologjine e matjeve : T - terren ; Z - zyre ; O - Ortofoto ; G - Gps ; S - Stacion Total ; D - Matje Distancash ;
**PERCAKTIMI I KUFIRIT :** P
Kode per percaktimin e kufirit : P - Perfaqesues i Pronareve ; K - Kufitaret te Gjithe ; KP - Kufitaret Pjeserisht ; PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale
**SHENIME TE VECANTA :** KUFIT U TREGUAN NGA PERFAQSUESIT E AUTORITETIT PORTUAL DURRES NE TERREN

**PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET**
EMRI :_________
NENSHKRIMI/VULA : ________

Kode per teknologjine e matjeve dhe per percaktimin e kufirit : T - terren ; Z - zyre ; O - Ortofoto ; G - Gps ; S - Stacion Total ; D - Matje Distancash ; P - Perfaqesues i Pronareve ; K - Kufitaret te Gjithe ; KP - Kufitaret Pjeserisht ; PB - Perfaqesues Bashkie ; HK - Harta Kadastrale

**VENDIM**
**Nr. 686, datë 26.10.2022**

## PËR MIRATIMIN E DËMSHPËRBLIMIT FINANCIAR PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të dënuar me burgim, izolim në hetuesi, izolim në institucion mjekësor apo mjekësor psikiatrik, sipas listës së përcaktuar në aneksin A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të dënuar me dënim kapital ose të ekzekutuar pa gjyq, sipas listës së përcaktuar në aneksin B, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Shpërndarja e masës së dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë bëhet me këste, sipas kritereve dhe kufijve të përcaktuar në nenin 12, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar.
4. Shuma e llogaritur transferohet në një llogari të posaçme në Bankën e Shqipërisë. Pagesa e dëmshpërblimit për secilin përfitues bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në llogaritë personale të tyre, të hapura në bankat e nivelit të dytë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2017, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar.
5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

# ANEKS A

| Nr. Rendor | Nr. Dosjes | Data e dosjes individuale | Emër | Mbiemër | Atësi | Amësi | Datëlindja | Vendlindja | Gjinia | Periudha e plotë e vuajtjes së dënimit | Shuma e dëmshpërblimit në lekë | Përfitimet nga ligje të mëparshme Ministria e Financave dhe Ekonomisë | | Enti Kombëtar i Banesave | ASHK | Dëmshpërblimi përfundimtar në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | Lekë | Letra me Vlerë | | | |
| 1 | 2026 | 28.02.2008 | Sokol | Vukcaj | Pashko | Mri | 04.07.1911 | Lohe e sipërme, Shkodër | M | 9 muaj | 558,000 | 0 | 89,573 | 0 | 0 | 468,427 |
| 2 | 7562 | 15.04.2008 | Hashim | Peposhi | Bajram | Hasime | 04.02.1920 | Lusën, Kukës | M | 3 vjet, 1 muaj, 19 ditë | 2,290,000 | 100,000 | 400,000 | 0 | 0 | 1,790,000 |
| 3 | 10619 | 03.06.2008 | Gjok | Prenga | Nikollë | Prendë | 15.04.1926 | Simon, Mirditë | M | 1 vit, 7 muaj | 1,164,000 | 100,000 | 400,000 | 0 | 0 | 664,000 |
| 4 | 12234 | 11.07.2008 | Dhimitër | Dharakli | Vasil | Stamato | 08.05.1910 | Dhrovjan, Sarandë | M | 2 vjet, 11 muaj, 30 ditë | 2,202,000 | 100,000 | 239,520 | 0 | 0 | 1,862,480 |
| 5 | 13169 | 18.08.2008 | Rushan | Mulla | Hasan | Temti | 23.05.1910 | Konispol, Sarandë | M | 16 vjet, 11 muaj, 5 ditë | 12,370,000 | 999,999 | 1,825,443 | 0 | 0 | 9,544,558 |
| 6 | 13860 | 17.09.2008 | Shaban | Kupi | Hasan | Zenepe | 01.02.1896 | Krujë | M | 6 mua e 26 ditë | 424,000 | 0 | 4,599,551 | 0 | 0 | 0 |
| 7 | 14266 | 03.10.2008 | Dyl | Ndreu | Murat | File | 16.11.1906 | Burrel, Mat | M | 2 vjet, 10 muaj, 8 ditë | 2,096,000 | 0 | 328,438 | 0 | 0 | 1,767,562 |
| 8 | 14525 | 15.10.2008 | Sherif | Ukthaçi | Gani | Marije | 18.06.1960 | Varazhdin | M | 1 vit, 2 muaj, 28 ditë | 910,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 0 |
| 9 | 16383 | 12.12.2008 | Svetozar | Veshoviq | Spasoje | Ljubeica | 24.04.1912 | Verushe, Jugosllavi | M | 5 vjet | 3,650,000 | 50,000 | 480,000 | 0 | 0 | 3,120,000 |
| 10 | 16431 | 29.01.2009 | Halil | Gjoni | Nexhip | Zene | 14.04.1923 | Vile, Durrës | M | 3 vjet, 1 muaj, 3 ditë | 2,258,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2,258,000 |
| 11 | 16706 | 18.12.2008 | Irakli | Gjoni | Janaq | Fotina | 14.09.1882 | Himarë, Vlorë | M | 9 vjet | 6,570,000 | 0 | 1,080,658 | 0 | 0 | 5,489,342 |
| 12 | 17137 | 19.12.2008 | Dilaver | Shehu | Myslim | Gjelahi | 10.06.1922 | Zerqan-Peshkopi | M | 1 vit, 7 muaj, 8 ditë | 1,180,000 | 100,000 | 0 | 0 | 0 | 1,080,000 |
| 13 | 17641 | 08.05.2009 | Eles | Kurtulla | Ali | Hitko | 01.09.1913 | Pocest, Dibër | M | 1 vit, 3 muaj, 20 ditë | 956,000 | 5,000 | 160,000 | 0 | 0 | 791,000 |
| 14 | 18186 | 08.05.2009 | Myftar | Pjeçi | Hajdar | Nurije | 01.01.1884 | Kryevidh, Kavajë | M | 7 muaj e 25 ditë | 520,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 520,000 |
| 15 | 19343 | 08.05.2009 | Selman | Xhediku | Xhelil | Maslije | 18.02.1906 | Tartaj, Diber | M | 9 vjet, 3 muaj, 5 ditë | 6,766,000 | 60,000 | 600,000 | 0 | 0 | 6,106,000 |
| 16 | 19945 | 05.06.2009 | Isa | Truma | Malush | Mejreme | 24.07.1929 | Ulwin | M | 2 vjet, 11 muaj, 22 ditë | 2,186,000 | 100,000 | 0 | 0 | 0 | 2,086,000 |
| 17 | 20017 | 09.06.2009 | Hasan | Ahmeti | Hysen | Hasije | 31.12.1908 | Armice e Çamërisë | M | 6 vjet, 8 muaj, 3 ditë | 4,882,000 | 0 | 360,165 | 0 | 0 | 4,521,835 |
| 18 | 20047 | 10.06.2009 | Gani | Ademi | Adem (Bej) | Hedo | 10.07.1908 | Gjirokastër | M | 27 ditë izolim në institucion mjekësor | 54,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 0 |
| 19 | 20054 | 10.06.2009 | Iljaz | Çanga | Selim | Nintime | 20.06.1880 | Dibër | M | 2 vite e 1 muaj | 1,522,000 | 0 | 258,000 | 0 | 0 | 1,264,000 |
| 20 | 20434 | 24.06.2009 | Spiro | Beçi | Robert | Elvira | 12.12.1962 | Ersekë | M | 3 muaj e 18 ditë | 222,000 | 0 | 35,178 | 0 | 0 | 186,822 |
| 21 | 20652 | 29.06.2009 | Gasper | Jubani | Zef | Marije | 12.05.1903 | Shkoder | M | 6 vjet, 1 muaj, 30 dite | 4,502,000 | 344 240 | 809 119 | 0 | 0 | 3,348,641 |
| 22 | 20663 | 29.06.2009 | Abdulla | Ndreu | Adem | Tane | 27.01.1941 | Tiranë | M | 11 muaj e 20 ditë | 722,000 | 0 | 116,712 | 0 | 0 | 605,288 |
| 23 | 20874 | 30.06.2009 | Ndoc (Karl) | Serreqi | Kol | Marije | 1911 | Shkodër | M | 5 vjet, 5 muaj, 26 ditë | 4,012,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4,012,000 |
| 24 | 20907 | 30.06.2009 | Mustafa | Rama | Ahmet | Farije | 13.03.1927 | Pashkashesh, Tiranë | M | D1 9 vjet, 6 muaj, 13 ditë D2 9 vjet, 6 muaj, 6 ditë | 12,762,000 | 200,000 | 2,088,219 | 0 | 0 | 10,473,781 |
| 25 | 21131 | 01.07.2009 | Jorgji | Gjorga | Mitro | Sofie | 02.04.1932 | Provli, Sarandë | M | 13 vjet, 9 muaj, 6 ditë | 10,060,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 10,060,000 |
| 26 | 21643 | 04.11.2011 | Samir | Gucija | Muharrem | Saime | 13.01.1963 | Shkodër | M | 2 vjet, 6 muaj, 8 ditë | 1,848,000 | 0 | 130,000 | 0 | 0 | 1,718,000 |
| 27 | 21662 | 03.06.2010 | Amir | Zonja | Petref | Asije | 09.11.1953 | Tiranë | M | 2 vite | 1,294,000 | 0 | 240,329 | 0 | 0 | 1,053,671 |
| 28 | 21707 | 16.12.2011 | Uran | Starova | Xhevat | Vizhdan | 03.08.1924 | Pogradec | M | 7 vjet, 9 muaj, 15 ditë | 5,698,000 | 100,000 | 844,548 | 0 | 0 | 4,753,452 |
| 29 | 21711 | 14.01.2011 | Zyhdi | Lila | Adem | File | 02.07.1925 | Tiranë | M | 2 vite, 2 muaj, 2 ditë | 1,628,000 | 100,000 | 165,000 | 0 | 0 | 1,363,000 |
| 30 | 21719 | 02.12.2009 | Hekuran | Ismaili | Hasan | Mahmude | 15.06.1922 | Osmënzezë, Berat | M | 3 vjet, 3 muaj, 28 ditë | 2,432,000 | 200,000 | 371,934 | 0 | 0 | 1,860,066 |
| 31 | 21780 | 30.03.2010 | Jani | Zoga | Anastas | Agllai | 30.04.1954 | Nartë, Vlorë | M | 12 vjet, 1 muaj, 25 ditë | 8,872,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 8,872,000 |
| 32 | 21786 | 10.04.2012 | Qazim | Jaho | Mehmet | Taibe | 16.01.1952 | Durrës | M | 1 vit, 2 muaj, 11 ditë | 876,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 876,000 |
| 33 | 21816 | 04.06.2014 | Nijazi | Noka | Sejdi | Shahe | 23.01.1941 | Tiranë | M | 4 vjet, 10 muaj, 12 ditë | 3,564,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3,564,000 |
| 34 | 21868 | 07.02.2013 | Tereza | Ruci | Qemal | Hatime | 17.03.1958 | Vlorë | F | 5 vjet, 8 muaj, 11 ditë | 4,168,000 | 200,000 | 483,256 | 0 | 0 | 3,484,744 |
| 35 | 21873 | 20.11.2009 | Shkëlqim | Lumi | Xhemali | Mynyre | 28.01.1954 | Lezhë | M | 5 vjet, 6 muaj, 16 ditë | 4,302,000 | 0 | 810,000 | 0 | 0 | 3,492,000 |
| 36 | 21895 | 07.08.2017 | Mehmet | Muslia | Shaban | Qazime | 14.02.1965 | Tiranë | M | 4 muaj | 248,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 248,000 |
| 37 | 21898 | 13.12.2017 | Agim | Pasha | Ismail | Feride | 01.07.1967 | Gjocaj, Burrel | M | 4 muaj | 234,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 234,000 |
| | | | | | | | | | | | | | | | | **103,538,669** |

# ANEKS B

| Nr. | Nr. i dosjes | Data e dosjes individuale | Emër | Mbiemër | Atësi | Amësi | Datëlindja | Vendlindja | Gjinia | Viti i vdekjes | Shuma e dëmshpërblimit në lekë | Përfitimet nga ligje të mëparshme | | | | Dëmshpërblimi përfundimtar në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | Ministria e Financës dhe Ekonomisë | | Enti Kombëtar i Banesave | ASHK | |
| | | | | | | | | | | | | Lekë | Letra me Vlerë | | | |
| 1 | 390 | 08.03.2008 | Sejfulla | Merlika | Osman | Sulltane | 06.03.2008 | Krujë | M | 18.07.1946 | 5,840,000 | 200,000 | 1,027,129 | 0 | 0 | 4,612,871 |
| 2 | 2886 | 06.03.2008 | Spiro | Kenuti | Spiro | Anastasia | 19.12.1953 | Dhivër, Sarandë | M | 25.10.1953 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| 3 | 3643 | 13.03.2008 | Gjok | Koleci | Gjergj | Dilë | 10.05.1910 | Gryk, Orosh, Mirditë | M | 30.11.1944 | 5,840,000 | 400,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,720,000 |
| 4 | 15490 | 19.11.2008 | Qazim | Banaj | Malo | Hava | 02.05.1904 | Pavar | M | 26.08.1947 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| 5 | 18587 | 08.05.2009 | Gani | Kulla | Ymet | Salije | 31.12.1885 | Zëmblak | M | 31.06.1945 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| 6 | 19025 | 08.05.2009 | Lulë | Gjelaj | Ndua | Mri | 15.07.1921 | Vukel | F | 31.03.1951 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4.920.000 |
| 7 | 19306 | 08.05.209 | Beqir | Valteri | Bajram | Dave | 31.01.1908 | Lis, Mat | M | 14.04.1945 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4.920.000 |
| 8 | 20438 | 24.06.2009 | Isa | Duraj | Shaqir | Rahime | 04.04.1911 | Gllave, Tepelenë | M | 14.04.1951 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| 9 | 20636 | 29.06.2009 | Fazli | Kastrati | Halil | Shkurta | 18.01.1917 | Golaj, Kukes | M | 30.04.1950 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| 10 | 20773 | 29.06.2009 | Ujk | Gjelaj | Nikë | Dilë | 20.01.1918 | Vukël, Shkodër | M | 13.02.1945 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| 11 | 20980 | 01.07.2009 | Sali | Zalli | Man | Bute | 04.12.1925 | Begaj, Tropojë | Mashkull | 05.08.1946 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| 12 | 21035 | 01.07.2009 | Pal | Marashi | Vat | Bute | 04.10.1899 | Iballë, Pukë | M | 15.09.1945 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| 13 | 21059 | 01.07.2009 | Gjon | Kaçaj | Lucë | Drande | 28.08.1898 | Bratosh | M | 15.03.1946 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| 14 | 21197 | 01.07.2009 | Bardhe | Bushkola | Mark | Gjel | 30.09.1935 | Lëkund, Mirditë | Femër | 05.09.1947 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| 15 | 21308 | 08.04.2011 | Preng | Loga | Gjergj | Bardhe | 23.04.1923 | Mal Bardhë, Krujë | M | 24.07.1948 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| 16 | 21344 | 08.04.2011 | Ismajl | Deda | Qerim | Cube | 31.12.1895 | Gjonpepaj, Tropojë | M | 13.03.1945 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| 17 | 21520 | 08.04.2011 | Medhat | Kavazi | Adem | Mirvete | 15.02.1905 | Dibër | M | 04.05.1949 | 5,840,000 | 200,000 | 720,000 | 0 | 0 | 4,920,000 |
| | | | | | | | | | | | | | | | | **73,292,871** |

**VENDIM**
**Nr. 687, datë 26.10.2022**

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË SPITALIT RAJONAL "MEMORIAL" NË FIER, SI APLIKUES I AUTONOMISË SPITALORE MENAXHERIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 55/2022, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Funksionimin e Spitalit Rajonal "Memorial" në Fier, si projekt pilot me status të veçantë si spital i nivelit terciar.

2. Spitali Rajonal "Memorial" në Fier ushtron veprimtarinë e tij në bazë të legjislacionit në fushën e shërbimit spitalor dhe bazuar në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, të ratifikuar me ligjin nr. 23/2021, me seli në Fier, pjesë e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

3. Spitali Rajonal "Memorial" në Fier aplikon autonominë menaxheriale, si një spital pilot për një periudhë 2-vjeçare, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë autonominë spitalore menaxheriale.

4. Ministri përgjegjës për shëndetësinë pajis spitalin "Memorial" në Fier me Kartën e Autonomisë Menaxheriale për një periudhë 2-vjeçare, e cila mirëpërcakton fushat në të cilën aplikohet autonomia menaxheriale.

5. Spitali Rajonal "Memorial" në Fier do të funksionojë për një periudhë tranzitore në bashkëpunim me personat e caktuar nga ministria e shëndetësisë turke, sipas protokollit të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet dy ministrave përkatës, përgjegjës për shëndetësinë, i miratuar me vendimin nr. 58, datë 26.1.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal 'Memorial' në Fier, gjatë fazës kalimtare".

6. Spitali Rajonal "Memorial" në Fier ofron shërbimet bazë, sipas listës së shërbimeve të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

7. Spitali Rajonal "Memorial" në Fier e ushtron veprimtarinë e tij, në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollet e diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

8. Rregullimet e përgjithshme dhe në hollësi të veprimtarisë së Spitalit Rajonal "Memorial" në Fier përcaktohen në statutin e spitalit, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

9. Organet drejtuese të Spitalit Rajonal "Memorial" në Fier, i pajisur me Kartën e Autonomisë Menaxheriale, janë:
a) Bordi Drejtues;
b) Ekipi menaxhues;
c) Administratori i Përgjithshëm.

10. Bordi Drejtues është organi kolegjial më i lartë drejtues i spitalit publik autonom dhe është i pavarur në veprimtarinë e tij. Përbërja dhe funksionet e bordit përcaktohen në rregulloren e autonomisë spitalore.

11. Ekipi menaxhues i spitalit autonom përbëhet nga administratori i Përgjithshëm, drejtuesit teknikë dhe ekonomikë. Detyrat e ekipit menaxhues përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të spitalit.

12. Administratori i Përgjithshëm i spitalit është autoriteti më i lartë ekzekutiv i spitalit autonom dhe emërohet nga Bordi Drejtues sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e autonomisë spitalore. Detyrat e administratorit të Përgjithshëm përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të spitalit.

13. Anëtarët e bordit marrin shpërblim për pjesëmarrje në mbledhje, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore.

14. Bordi Drejtues raporton periodikisht pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

15. Financimi nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor realizohet sipas paketave të shërbimeve spitalore, në

përputhje me listën e shërbimeve të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

16. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratë me Spitalin Rajonal "Memorial" në Fier për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore, duke përfshirë shpenzimet për personelin, shërbimet korrente dhe paketat e shërbimeve të ofruara dhe kontrollon e monitoron buxhetin spitalor, aktivitetin vjetor të spitalit, bazuar në indikatorët e performancës, nëpërmjet strukturave të tyre audituese e kontrolluese, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

17. Të ardhurat dytësore, të realizuara nga Spitali Rajonal "Memorial" në Fier, përdoren nga vetë spitali, sipas kritereve që përcaktohen në statut dhe miratohen nga Bordi Drejtues i spitalit.

18. Struktura dhe organika e spitalit miratohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, me propozimin e Bordit Drejtues të spitalit.

19. Personeli i kujdesit shëndetësor turk caktohet nga Republika e Turqisë gjatë fazës së transicionit të Spitalit Rajonal "Memorial" në Fier, në zbatim të nenit 1, të marrëveshjes së lidhur, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, ratifikuar me ligjin nr. 23/2021.

20. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të spitalit rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

21. Institucionet kompetente ushtrojnë kontroll mbi veprimtarinë e Spitalit Rajonal "Memorial" në Fier, sipas legjislacionit në fuqi dhe brenda fushës së tyre të përgjegjësisë.

22. Spitali Rajonal "Memorial" në Fier ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: "Republika e Shqipërisë; Spitali Rajonal "Memorial" në Fier, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

23. Vendimi nr. 175, datë 17.3.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Spitalit Rajonal "Memorial" në Fier, si projekt pilot", i ndryshuar, shfuqizohet.

24. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, që hyjnë në fuqi më 1 janar 2023.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 688, datë 26.10.2022**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 299, DATË 8.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË TREGTIMIT TË BARNAVE E TË KLASIFIKIMIT TË TYRE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 5, dhe 12, pika 3, të ligjit nr. 105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores, që i bashkëlidhet vendimit nr. 299, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, te "KLASIFIKIMI I NDRYSHIMEVE", pas pikës B.I.a.4, shtohen pikat B.I.a.5 dhe B.I. a.6, me përmbajtje sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

| B.I.a.5 Ndryshime të lëndës aktive të një vaksine sezonale, pre-pandemike ose pandemike kundër human influenza | Kushtet që duhet të përmbushen | Dokumentacioni i kërkuar | Tipi i procedurës |
|---|---|---|---|
| a) Zëvendësim i një shtami/eve të një vaksine sezonale, prepandemike ose pandemike kundër influencës humane. | | | II |

| B.I.a.6 Ndryshime të lëndës aktive të një vaksine kundër koronavirusit human | Kushtet që duhet të përmbushen | Dokumentacioni i kërkuar | Tipi i procedurës |
|---|---|---|---|
| b) Zëvendësim ose shtim i një serotipi, shtami, antigjeni ose sekuence koduese ose kombinim i serotipave, shtameve, antigjeneve ose sekuencave koduese të vaksinës kundër koronavirusit human. | | | II |

**VENDIM**
**Nr. 689, datë 26.10.2022**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TEK FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË OBJEKTIT ME EMËRTIM "ISH-SANATORIUMI", BASHKIA KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës së ndodhur në zonën kadastrale nr. 8562, me nr. pasurie 3/200 (ndërtesë dhe truall), me sipërfaqe të përgjithshme të truallit 6 888 $m^2$ (gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) dhe sipërfaqe të përgjithshme të ndërtesave mbi këtë truall 1 581.6 $m^2$ ndërtim (një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një pikë gjashtë), me emërtimin "Ish-Sanatoriumi", Bashkia Korçë, sipas plan-vendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ndërtimin e Polit Universitar Korçë për drejtimet e mikpritjes, bujqësisë dhe inovacionit.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Korçë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

iratuar nga V. K. M. Nr. 519, Date 7.11.1994

# KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 18, Fq. 248

--> Vijon nga: Vol. ______, Fq. ______

**- SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE**

Zona Kadastrale: 8562 NR. i PASURISE: 3/200 Vijon në: Vol. ______, Fq. ______ deri në: Vol. ______, Fq. ______ -->

**PERFUNDIMTARE** (data): 14.10.(?)09

Indeksi i Hartës: KO; 0-10

**Adresa e pasurisë** : Rrethi KORÇE Q/F KORÇE

Rr/L "NENE TEREZA" P/G ______ Sh ______ K ______ Ap ______

**- SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE**

Lloji i Pasurisë : TRUALL | Brenda V.K.N. : Jo --> (PO). Ref : PL. RREG.

| Sip. Totale e Pasurisë | Nga Sip. Totale: sa Truall | Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë |
|---|---|---|
| 1. 6814 m² Ref LN TETOR 03 | 1. 6814 m² Ref LN TETOR 03 | 1. 1581.6 m² Ref LN TETOR 03 |
| 2. 7036 m² Ref 017382 | 2. 7036 m² Ref 017382 | 2. 1581.6 m² Ref 017382 |
| 3. ______ m² Ref ______ | 3. ______ m² Ref ______ | 3. ______ m² Ref ______ |
| 4. ______ m² Ref ______ | 4. ______ m² Ref ______ | 4. ______ m² Ref ______ |

Për pjesën e përbashkët:

PALLAT

Kuota e Pjesëmarrjes: ______ %

Nr. i Pasurisë (Pallat): ______

Vol. ______ Fq. ______

Përshkrim i Veçantë

SENATORIUMI
- SHKRESA 1911/1 dt. 19.04.2012 KERKESE NGA ORSH KORÇE [illegible] URDHRIT [illegible] TE MINISTRIT SHENDETESISE

017382 - [illegible]

09047 - [illegible] PASURI KA [illegible] PER AJOHJE PRONAR Z. KOSTAQ DHIMITER [illegible] NR. 1330 DT. 2.2.1996

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS · SEKRETARIA · KORÇË · DREJTORIA VENDORE

**C - SEKSIONI I PRONESISE**

| Nr.Dok | Data Regjistrim | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 26.11.2003 | SHTET | | | | | | | |

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik [illegible]

| Nr. Dok | Data e Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh. të Çertifikatës |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT KORÇË SEKRETARIA KËSHILLIT DREJTORIA VENDORE

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj.

| Nr. Dok | Data e Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh. të Çertifikatës |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |


SEKRETARI KORÇË DREJTORIA VENDORE
3/200
3/262
3/200
3/194
3/192
3/193
3/621
3/200
3/195
3/645
3/580
3/200
3/580
3/204


8/203
8/258
8/333
8/258
8/260
8/259
8/257
8/262
8/261

**VENDIM**
**Nr. 690, datë 26.10.2022**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR MEKANIZMAT E SIGURIMIT TË USHQIMIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes "Për mekanizmat e sigurimit të ushqimit në Ballkanin Perëndimor".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**MARRËVESHJE**
PËR MEKANIZMAT E SIGURIMIT TË USHQIMIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Duke pasur parasysh mirëqenien e qytetarëve të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe me synimin më të mirë për të parandaluar mungesat e produkteve thelbësore agroushqimore në tregjet e pjesëmarrësve të Nismës për Ballkanin e Hapur;

Duke rikonfirmuar solidaritetin si parim përcaktues të Nismës për Ballkanin e Hapur;

Duke shprehur vullnetin për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe me synimin për të kontribuar në mekanizmat e sigurisë ushqimore në kuadër të Nismës për Ballkanin e Hapur dhe në një rajon në tërësi;

Me qëllim përcaktimin e mënyrave për sigurimin e tregtisë së vazhdueshme për të lejuar furnizim të qëndrueshëm dhe të pandërprerë të qarkullimeve me produkte agroushqimore thelbësore brenda palëve kontraktuese pa asnjë kufizim;

Duke qenë të vetëdijshëm dhe duke dëshiruar të zvogëlojnë mungesat e mundshme të furnizimit me ushqime në rajonin tonë, të shkaktuara nga ndërprerjet në prodhim dhe transport për shkak të situatave të krizës;

Duke ftuar pjesëmarrësit e tjerë të Ballkanit Perëndimor që t'i bashkohen kësaj marrëveshjeje në frymën e gjithëpërfshirjes, marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal dhe me synimin për të përmirësuar mirëqenien e qytetarëve brenda rajonit;

Në përputhje me Marrëveshjen mbi Bashkëpunimin në Fushën e Veterinarisë, Sigurisë Ushqimore dhe Ushqimit për Kafshë dhe Fitosanitare në Ballkanin Perëndimor, nënshkruar nga të njëjtat Palë, më 21 dhjetor 2021,

Palët kanë rënë dakord si vijon.

Neni 1

Në përputhje me Marrëveshjen për bashkëpunim në mbrojtje nga fatkeqësitë në Ballkanin Perëndimor, qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që pjesëmarrësit e Nismës së Ballkanit të Hapur të ndihmojnë njëra-tjetrën në rast të ndërprerjes së zinxhirëve të furnizimit, për shkak të pasojave të krizës globale, kur njëra nga palët përballet me mungesa në furnizimin e tregut vendës me produkte thelbësore agroushqimore.

Palët, si anëtarë të Nismës së Ballkanit të Hapur, rikonfirmojnë nevojën e bashkëpunimit në parandalimin dhe zvogëlimin e mungesave të mundshme të produkteve thelbësore agroushqimore, të krijuara nga një situatë e mundshme krize, qoftë brenda rajonit ose asaj që ndikon në tregun global dhe që reflekton në rajon.

Neni 2

Palët bien dakord se nuk do të ketë ndalime në tregtimin e produkteve thelbësore agroushqimore brenda anëtarëve të Nismës për Ballkanin e Hapur.

Lista e produkteve thelbësore agroushqimore është e specifikuar në aneksin I të Marrëveshjes.

Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, palët do të shfuqizojnë të gjitha kufizimet sasiore dhe masat me efekt të njëjtë për importet e produkteve thelbësore agroushqimore të specifikuara në aneksin I, me origjinë nga anëtarët e Nismës për Ballkanin e Hapur.

Neni 3

Palët bien dakord që nuk do të ketë rieksportim në vende të treta, të produkteve thelbësore

agroushqimore të tregtuara, të listuara në aneksin I, nëse kanë origjinën nga njëra prej Palëve.

Neni 4

Me qëllim monitorimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të krijojnë Grupin e Përbashkët të Punës për të sugjeruar përmirësime përballë ndryshimeve në mjedis dhe për të zbuluar dhe parandaluar abuzime të mundshme. Ky grup pune do të krijohet brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Grupi i Punës do të përfshijë përfaqësues të institucioneve zyrtare të palëve, përgjegjëse për bujqësinë, tregtinë dhe doganat dhe përfaqësues të dhomave të tregtisë. Përfaqësuesi duhet të jetë të paktën në nivelin e drejtuesit të departamentit. Secila palë do t'u njoftojë palëve të tjera emrat e përfaqësuesve të caktuar në Grupin e Punës. Palët mund të caktojnë edhe zëvendëspërfaqësues në çdo kohë, duke i njoftuar me shkrim palët e tjera.

Neni 5

Palët bien dakord që autoritetet e tyre kompetente do të punojnë së bashku për të hartuar kapacitetet e magazinimit për produktet thelbësore agroushqimore brenda palëve.

Kapacitetet e ruajtjes do të hartohen plotësisht brenda 90 ditëve nga dita pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Për të zhvilluar bashkëpunimin në terren, autoritetet kompetente të Palëve do të shkëmbejnë listën e tyre të kapaciteteve të hartuara të drithërave.

Neni 6

Palët bien dakord që autoritetet e tyre kompetente do të punojnë së bashku për të hartuar një plan të përbashkët politik për përmirësimin e kapaciteteve për magazinimet e produkteve thelbësore agroushqimore brenda Nismës për Ballkanin e Hapur, brenda 90 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Palët angazhohen të shqyrtojnë veprime shtesë në tregtinë e ndërsjellë për të trajtuar ofrimin e produkteve thelbësore agroushqimore gjatë situatave të krizës.

Palët angazhohen të rishikojnë klauzola të përgjithshme dhe specifike të përjashtimit në tregtinë e ndërsjellë për të inkurajuar bashkëpunimin në situata krize.

Neni 8

Palët bien dakord që autoritetet e tyre kompetente do të punojnë së bashku për të hartuar UDHËRRËFYESIN OBI TË SIGURISË USHQIMORE/PLANIN E VEPRIMIT 2030.

Dokumenti do të trajtojë çështjet e sigurisë ushqimore në Ballkanin Perëndimor, në përgjithësi, dhe në Nismën për Ballkanin e Hapur, në veçanti, të tilla si në identifikimin e rrezikut dhe sfidave për sigurinë ushqimore, duke u fokusuar në nismat e mëposhtme për të adresuar efektet e ndryshimeve klimatike (thatësira, përmbytje, zjarre etj.), digjiitalizimin dhe inovacionin në industrinë ushqimore dhe qëndrueshmërinë në prodhimin e ushqimit në të gjithë rajonin dhe zinxhirin e vlerës agroushqimore.

Neni 9

Palët bien dakord të rishikojnë në nivel kombëtar, sipas rastit, rregulloret që janë identifikuar si potencialisht sfiduese për funksionimin e zinxhirit të furnizimit ushqimor brenda rajonit të Nismës për Ballkanin e Hapur.

Neni 10

Mosmarrëveshjet që lindin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen me negociata ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve.

Neni 11

Marrëveshja nuk do të zbatohet për të drejtat dhe detyrimet e Palëve që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare, në të cilat ato janë palë kontraktuese.

Neni 12

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me të cilin

Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet Depozitarit, për përfundimin e procedurave të kërkuara sipas legjislacionit të tyre të brendshëm për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Republika e Serbisë do të veprojë si Depozitari i kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë pesëvjeçare (5-vjeçare). Pas kësaj periudhe, Marrëveshja do të zgjatet automatikisht për periudha pasuese njëvjeçare.

Secila Palë mund të tërhiqet nga Marrëveshja në çdo kohë, duke njoftuar dy Palët e tjera me shkrim, nëpërmjet Depozitarit, jo më vonë se gjashtë (6) muaj para datës së tërheqjes.

Në këtë rast, Marrëveshja do të mbetet në fuqi për dy Palët e mbetura.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të të gjitha Palëve.

Origjinali i kësaj Marrëveshjeje, në një kopje të vetme në gjuhën angleze, do të depozitohet pranë Depozitarit i cili do t'i transmetojë një kopje të vërtetuar secilës Palë.

Bërë në Beograd, më dy shtator dy mijë e njëzet e dy.

**Për Qeverinë e Republikës së Serbisë**

______________

**Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë**

______________

**Për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

______________

ANEKSI I
LISTA E PRODUKTEVE THELBËSORE AGROUSHQIMORE

| Përshkrimi | Kodi tarifor |
|---|---|
| Misër | 1005 |
| Grurë dhe lloj gruri | 1001 |
| Grurë dhe lloj gruri | 1101 |
| Qumësht dhe produktet e qumështit | 0401 deri 0406 |
| Sheqer kallami ose panxhari dhe saharozë kimikisht të pastër, në formë të ngurtë | 1701 |
| Farë luledielli, vaj luledielli ose pambuku dhe fraksionet e tyre, të rafinuara ose jo, por jo të modifikuara kimikisht | 1512 |
| Farë luledielli | 1206 |
| Makarona, të gatuara ose jo ose të mbushura (me mish ose substanca të tjera ose të gatuara ndryshe, si spageti, makarona, noordles, lasanja, njoki, ravioli, kaneloni, kuskus, të përgatitura ose jo | 1902 |
| Drithërat, miell dhe pelet | 1103 |
| Fruta dhe arra; lëvozhga e agrumeve ose pjeprit | 0801 deri 0814 |
| Perime të ngrënshme dhe disa rrënjë dhe zhardhokë | 0701 deri 0714 |
| Mish dhe të brendshmet e mishit të ngrënshëm | 0201 deri 0210 |
| Salsiçe dhe produkte të ngjashme, prej mishi, të brendshmet e mishit, gjaku ose insektet; përgatitjet ushqimore të bazuara në këto produkte | 1601 |
| Mish tjetër të përgatitur ose të konservuar, të brendshmet e mishit, gjak ose insekte | 1602 |

## UDHËZIM
## Nr. 22, datë 27.10.2022

## PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, PROCEDURAVE DHE METODOLOGJISË PËR SUBJEKTET DHE KLIENTËT FAMILJARË, QË PËRFITOJNË NGA MASAT E FINANCIMIT PËR KURSIMIN E ENERGJISË NGA PANELET DIELLORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 7, të aktit normativ nr. 14, datë 5.10.2022, "Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizim me energji elektrike", ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZON:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Agjencia e Efiçencës së Energjisë (Agjencia) financon projektet për instalimin e paneleve diellore për ngrohjen e ujit sanitar për klientët familjarë.

2. Financimi përfshin 70% të vlerës së investimit. Financimi i masës mbështetëse bëhet vetëm nga të ardhurat për shërbime ndaj të tretëve, të arkëtuara nga Agjencia gjatë vitit buxhetor. Të ardhurat e Agjencisë për këtë qëllim, të cilat nuk janë shpenzuar gjatë vitit ushtrimor, në zbatim të aktit normativ, mbarten në vitin pasardhës.

3. Agjencia publikon në fazën e parë të procesit subjektet që kanë shfaqur interes për ofrimin e shërbimit të shitjes dhe instalimit të paneleve diellore për ngrohjen e ujit sanitar.

4. Subjektet që ofrojnë shërbimin e furnizimit dhe të instalimit të paneleve diellore për ngrohjen e ujit, përzgjidhen nga Agjencia në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë udhëzim.

5. Agjencia publikon në faqen e saj të internetit thirrjen për subjektet që ofrojnë tregtimin dhe instalimin e sistemeve diellore. Afati i lejuar për dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm për pjesëmarrje nga subjektet tregtare nuk mund të jetë më pak se 12 ditë pune.

6. Subjektet e kualifikuara nënshkruajnë një kontratë standarde me Agjencinë në të cilën përcaktohen kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, duke përfshirë dhe masat administrative, për rastet e tilla si: mosrespektimi i afatit, mospërfundimi i instalimit, mosfunksionimi i sistemit, mospërgjigjja brenda periudhës së garancisë. Me firmosjen e kontratës, Agjencia publikon në faqen e saj të internetit listën e subjekteve që kualifikohen për ofrimin e shërbimit.

7. Klientët familjarë aplikojnë për përfitimin e financimit në platformën *online* të krijuar për këtë qëllim pranë Agjencisë. Aplikimi duhet të jetë në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

8. Aplikimet për përfitimin e financimit trajtohen dhe miratohen sipas radhës që paraqiten. Menjëherë pas vlerësimit, Agjencia njofton aplikuesin për miratimin ose refuzimin e kërkesës për financim. Për aplikimet që refuzohen, Agjencia njofton në çdo rast arsyet e refuzimit në rrugë elektronike. Klientët familjarë, aplikimi i të cilëve është refuzuar, nuk mund të bëjnë rregullime në aplikimin ekzistues, por kanë të drejtë të aplikojnë përsëri, duke çelur një aplikim të ri.

II. KRITERET PËR PJESËMARRJEN E SUBJEKTEVE QË OFROJNË TREGTIMIN DHE INSTALIMIN E SISTEMEVE DIELLO-RE

1. Subjektet që shprehin interes për të marrë pjesë në këtë procedurë duhet:

a) Të jenë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas legjislacionit në fuqi; të kenë status aktiv dhe të kenë në fushën e veprimtarisë objektin e financimit;

b) Të vërtetojnë se nuk kanë detyrime ndaj organeve tatimore dhe të energjisë elektrike;

c) Të disponojnë dokumente që vërtetojnë se sistemi plotëson standardet evropiane dhe certifikimin "CEN Solar Keymark", që garanton cilësi të lartë të produktit, siguri në përdorim, jetëgjatësi dhe rendiment të lartë, si dhe të ketë karakteristikat teknike të mëposhtme;

i. i gjithë sistemi të jetë me rezistence të lartë ndaj ndryshkjes;

ii. të jetë i përshtatshëm, si për montim në çati, ashtu dhe në tarracë;

iii. të jenë prodhim i vitit 2022;

iv. tubat e brendshëm të jenë tërësisht prej material bakri;

Specifikimet e hollësishme për të garantuar qëndrueshmërinë e sistemit për të gjithë përudhën e garancisë përzgjidhen nga Agjencia dhe publikohen në faqen e saj zyrtare.

d) Të disponojnë skedën teknike të instalimit termik konform kritereve teknike të kërkuara;

e) Oferta financiare për instalimin termik për një klient familjar përfshin edhe kostot e transportit dhe të instalimit. Oferta financiare do të jetë detyruese dhe ofertuesi nuk mund të lëshojë faturë me çmim të ndryshëm nga oferta e paraqitur.

2. Lista e dokumenteve që duhet të paraqesin subjektet:

a) certifikatë regjistrimi/ NIPT;

b) ekstrakti historik;

c) vërtetim për pagim detyrimesh tatime;

d) vërtetim për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave energjetike të subjektit të regjistruar në Shqipëri;

e) të paraqesë certifikimin "CEN Solar Keymark" për panelet që ofron;

f) të deklarojë sasinë e paneleve diellore të disponueshme për klientët familjarë;

g) të deklarojë një listë të qyteteve ku mund të ofrojë shërbimin;

h) të sigurojë përmes një deklarate garancinë e sistemit të panelit diellor;

i) të paraqesë skedën teknike të paneleve që ofron;

j) të disponojë një deklaratë përgjegjësie për çdo kontrate shitjeje, sipas së cilës pranon kryerjen e shërbimit kundrejt klientëve familjarë nga shitja deri tek kolaudimi i sistemit termik për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar, brenda datës 30 janar 2023;

k) të angazhohet nëpërmjet një deklarate, ku pranon se mënyra e kreditimit për tregtimin, shitjen dhe instalimin e sistemit termik do të jetë vetëm 30% të financimit nga klientët familjarë dhe 70% të investimit nga Agjencia;

l) të paraqesë formularin e vetëdeklarimit, sipas shtojcës 1.

III. KRITERET DHE KUSHTET E APLIKIMIT TË KLIENTËVE FAMILJARË

1. Klientët familjarë që kërkojnë të aplikojnë për përfitimin e mbështetjes për realizimin e investimit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të paraqesin një kontratë ekzistuese me OSHEE/Furnizuesi i Shërbimit Universal ku të jenë të klasifikuar si abonent familjar dhe një historik të konsumit të energjisë për të paktën 6 muaj, që nuk duhet të jetë më pak se 250 kwh për çdo muaj;

b) të paraqesin vërtetim debie nga OSHEE nga *e-Albania,* që të vërtetojë se nuk janë debitorë për pagesën e energjisë elektrike, ose janë në një marrëveshje për shlyerjen me këste të detyrimeve të prapambetura;

c) kriteret e pikës "a" nuk zbatohen për abonentët që klasifikohen si konsumatorë që trajtohen me ndihmë ekonomike nga ministria përgjegjëse për punët sociale;

d) të zotërojnë certifikatë pronësie për banesën ose njësinë e banimit (rastet që janë në proces legalizimi nuk do të konsiderohen).

2. Lista e dokumenteve që duhet të paraqesin konsumatorët familjarë për aplikim në platformën *online*:

a) letërnjoftimi (karta e identitetit);

b) certifikata familjare;

c) certifikatë pronësie;

d) faturat e energjisë elektrike për të paktën 6 muajt e fundit të konsumit;

e) vërtetim debie nga OSHEE-ja të marrë nga *e-Albania* që abonenti nuk rezulton debitor për pagesën e energjisë elektrike ose që ka nënshkruar një marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura;

f) foto në të cilat tregohet qartë pamja e jashtme e objektit ku do të instalohen panelet diellore për ngrohjen e ujit;

g) për konsumatorët që trajtohen me ndihmë ekonomike, dokument që vërteton se janë përfitues të ndihmës ekonomike;

h) formulari e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 2.

IV. MËNYRA E APLIKIMIT DHE E FINANCIMIT TË KLIENTËVE FAMILJARË

1. Të gjithë klientët familjarë që plotësojnë kriteret e kreut II, do të aplikojnë në portalin e publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë: www.eficenca.gov.al, duke ngarkuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Portali bën renditjen e dy mijë aplikimeve të para që pajisen me numrin përkatës në mënyrë automatike.

2. Brenda 2 ditëve punë nga data e pajisjes me numrin përkatës, Agjencia miraton ose refuzon aplikimin dhe njofton aplikuesin në mënyrë elektronike.

3. Me marrjen e konfirmimit nga Agjencia, klienti familjar duhet të konfirmojë porosinë te subjekti tregtues brenda 7 ditëve pune, duke paguar 30% të faturës. Mandati i pagesës së bërë dërgohet te Agjencia dhe regjistrohet.

4. Klientët familjarë që nuk konfirmojnë porosinë dhe, si rezultat, nuk dërgojnë mandatin e

pagesës prej 30% të faturës brenda afateve të pikës 3 të këtij kreu, humbasin të drejtën e financimit. Këto klientë kanë të drejtë të aplikojnë përsëri, duke çelur një aplikim të ri.

5. Me plotësimin e dy mijë aplikimeve të para, klientët familjarë që tërhiqen nga aplikimi për arsye vetjake ose arsye të tjera të përcaktuara në këtë udhëzim, pozicioni i tyre plotësohet nga aplikuesi i radhës, deri në riplotësimin e kuotave.

6. Nga momenti i parapagimit të faturës nga klienti familjar, subjektet tregtare duhet të instalojnë sistemin brenda 15 ditëve pune. Masat administrative për mosrespektimin e afateve parashikohen në kontratën standarde.

7. Klientët familjarë, në çdo rast, duhet të zbatojnë legjislacionin në fuqi për instalimin e këtyre paneleve, si dhe për marrjen e dakordësisë nga bashkëpronarët e tjerë nëse është e aplikueshme.

8. Financimi përfshin 70% të vlerës impiantit dhe tëkostos së instalimit. Financimi i masës mbështetëse bëhet vetëm nga të ardhurat për shërbime ndaj të tretëve, të arkëtuara nga Agjencia gjatë vitit buxhetor.

9. Financimi nga Agjencia realizohet në favor të subjektit të përzgjedhur nga klienti familjar.

10. Financimi do t'i jepet subjektit në përputhje me termat e parashikuar, sipas kontratës standarde me Agjencinë.

V. ZBATIMI DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

1. Autoriteti përgjegjës për ndjekjen e këtij procesi është struktura e posaçme e krijuar në OSHEE Group, Task-Forca e Energjisë, e cila realizon procesin e monitorimit dhe verifikimit të investimeve të realizuara me mbështetjen e kësaj thirrje përmes një procedure transparente.

2. Me përfundimin e investimit subjektet tregtare njoftojnë përmes adresës elektronike ose pranë zyrave të Agjencisë, brenda 5 ditëve nga momenti i instalimit, të dhënat e mëposhtme:

i. nr. serial të pajisjeve të instaluara;

ii. garancinë e marrë nga furnizuesi i pajisjes;

iii. kopje e faturës;

iv. foto të të gjithë pajisjeve që janë përfshirë në investim dhe foto të objektit gjatë punimeve dhe pas realizimit të investimit;

v. deklarata e klientit familjar që ka marrë shërbimin, sipas shtojcës së vendosur në kontratën standard midis subjekteve tregtuese dhe Agjencisë.

3. Task-Forca e Energjisë njoftohet për çdo instalim të përfunduar dhe që ka dërguar të dhënat e mësipërme.

4. Për çdo mospërputhje, parregullsi dhe falsifikim, Task-Forca e Energjisë merr masat përkatëse dhe subjekti tregtues është i detyruar të kthejë të gjithë shumën e përftuar.

5. Agjencia bashkërendon proceset e përcaktuara në këtë udhëzim dhe trajton sipas rastit problematikat që paraqiten nga klientët familjarë. Për çdo shkelje të subjekteve në dëm të klientëve familjarë, Agjencia aplikon masa administrative sipas kontratës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
**Belinda Balluku**

SHTOJCA 1
FORMULARI I VETËDEKLARIMIT PËR SUBJEKTIN TREGTAR

Unë, i nënshkruari, ________________, deklaroj këtu, se:

- Kam lexuar dhe kuptuar kushtet dhe detyrimet e thirrjes.
- Plotësoj kriteret teknike të depozitës së ujit dhe të panelit diellor, sipas kërkesave të Agjencisë së Efiçencës së Energjisë.
- Në çmimin e ofruar për klientët familjarë të përzgjedhur përfshihet edhe kostot e transportit dhe instalimit.
- Do të zbatoj legjislacionin në fuqi për instalimin e panelit diellor dhe kushtet përkatëse teknike.
- Pranoj kushtin e pranimit të 30% të financimit nga klientët familjarë dhe 70% të investimit nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë pas instalimit të panelit diellor.
- Informacioni i përfshirë në këtë aplikim, së bashku me çdo deklaratë të shprehur është, në dijeninë time, i vërtetë, i saktë dhe i plotë.
- Nëse ndonjë nga deklaratat e bëra në aplikim është e pasaktë, e paplotë, e rreme apo me karakter mashtrues ndaj Agjencisë për Efiçencën e Energjisë, mundet, në diskrecionin e tij absolut, të ndërmarrë masat e duhura. Mirëkuptoj se të tilla

masa mund të çojnë në mospërfshirjen e aplikimit për shqyrtim të mëtejshëm dhe/ose kthimin mbrapsht të të gjithë financimit të përftuar.

Mbiemri/Emri dhe firma e aplikantit

SHTOJCA 2
FORMULARI I VETËDEKLARIMIT PËR KLIENTIN FAMILJAR

Unë, i nënshkruari, _______________, deklaroj këtu, se:

- Deklaroj kam lexuar dhe kuptuar kushtet dhe detyrimet e thirrjes.

- Deklaroj se informacioni i përfshirë në këtë aplikim, së bashku me çfarëdo deklarate të shprehur është, në dijeninë time, i vërtetë, i saktë dhe i plotë.

- Pranoj se, nëse ndonjë nga deklaratat e bëra në aplikim është e pasaktë, e paplotë, e rreme apo me karakter mashtrues ndaj ____________________, mundet, në diskrecionin e tij absolut, të ndërmarrë masat e duhura. Mirëkuptoj se të tilla masa mund të çojnë në mospërfshirjen e aplikimit për shqyrtim të mëtejshëm dhe/ose kthimin mbrapsht të të gjithë financimit të përftuar.

- Nuk jam nën hetim, procedim penal apo dënuar për ndonjë vepër penale nga institucionet e drejtësisë në Shqipëri.

Mbiemri/Emri dhe firma e aplikantit

**VENDIM**
**Nr. 20, datë 22.9.2022**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Vitore Tusha | kryetare; |
| Marsida Xhaferllari | anëtare; |
| Fiona Papajorgji | anëtare; |
| Elsa Toska | anëtare; |
| Altin Binaj | anëtar; |
| Sandër Beci | anëtar; |
| Sonila Bejtja | anëtare, |

me sekretare Belma Lleshi, në datën 22.9.2022, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 1 (D) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Dritan Kiçi

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1140, datë 6.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1884, datë 4.11.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2021-713, datë 21.9.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 17, 29, 33, 42, 43, 122, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 6, 7, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; nenet 22, 27, 49, 50, 70, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Dritan Kiçi në datën 1.2.2010 ka themeluar shoqërinë "R." sh.p.k., duke zotëruar si ortak i vetëm 100% të kuotave dhe është vetemëruar administrator i saj për ushtrimin e veprimtarisë tregtare në fushën e prodhimit të filmave, botimeve etj. Në datën 8.2.2010 ka shitur 51% të kuotave të kësaj shoqërie te shtetasi E.Q., duke zotëruar në vijim 49% të kuotave dhe njëkohësisht ka vijuar të jetë administrator i saj. Në muajin maj të vitit 2011, shtetasi E.Q. ka konstatuar probleme që lidheshin me mënyrën e administrimit të shoqërisë nga ana e kërkuesit, ndaj të cilit ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

*(prokuroria)*, me pretendimin se ka shpërdoruar kompetencat si administrator i shoqërisë, ka falsifikuar dokumentacionin e saj dhe ka mashtruar në lidhje me aktivitetin tregtar. Bazuar në këtë kallëzim penal, prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. 1588 të vitit 2012 dhe, në përfundim të hetimeve paraprake, ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuesit, duke e akuzuar për kryerjen e veprave penale "Mashtrimi", "Falsifikimi i dokumenteve" dhe "Shpërdorimi i kompetencave", të parashikuara përkatësisht nga nenet 143, paragrafi i dytë, 186, paragrafi i dytë dhe 164 të Kodit Penal *(KP)*, së bashku me shtetasin R.L. (ekonomist në shoqërinë "R." sh.p.k.).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1140, datë 6.5.2014, ndër të tjera, ka vendosur: "*Deklarimin fajtor të të pandehurit Dritan Kiçi, për kryerjen e veprës penale 'Mashtrimi' dhe bazuar në nenin 143, pika 2, të KP-së dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Dritan Kiçi, për kryerjen e veprës penale 'Falsifikimi i dokumenteve' dhe bazuar në nenin 186, pika 2, të KP-së, dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Dritan Kiçi, për kryerjen e veprës penale 'Shpërdorimi i kompetencave' dhe bazuar në nenin 164 të KP-së, dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. Në zbatim të nenit 55, pika 1, të KP-së të pandehurit Dritan Kiçi i caktohet një dënim i vetëm me 10 (dhjetë) vjet burgim.*". Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1884, datë 4.11.2015, ka vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit nr. 1140, datë 6.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*". Kërkuesi në datën 4.12.2015 ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Ndërkohë që çështja qëndronte në pritje për t'u gjykuar nga Gjykata e Lartë, me ligjin nr. 36/2017, datë 30.3.2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar" *(ligji nr. 36/2017)*, ndër të tjera, u ndryshua masa e dënimit për veprën penale "Mashtrimi", të parashikuar në nenin 143, paragrafi i dytë, të KP-së, nga dënimi me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet, në dënimin me burgim nga dy gjer në gjashtë vjet.

4. Në lidhje me rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-713, datë 21.9.2021, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin, se: "*asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nuk u referohet shkaqeve të rekursit të parashikuara nga 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP). Kolegji çmon se nuk ka shkaqe për cenimin e vendimmarrjes së gjykatave të faktit. Pavarësisht se Kolegji Penal nuk i hyn vlerësimit të provave në çështjen objekt gjykimi, nga shqyrtimi i çështjes referuar shkaqeve të rekursit të paraqitur nga rekursuesi, nuk rezulton që të ketë shkaqe për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*".

5. Me kërkesën e datës 19.1.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të saj dhe në datën 18.2.2022 ka paraqitur pretendime shtesë në lidhje me procedurat e zhvilluara në Gjykatën e Lartë.

6. Me vendimin e datës 29.3.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

## II
## Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkuesi*** ka pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor dhe shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë ka cenuar:

7.1 *Parimet e prezumimit të pafajësisë dhe mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, të parashikuara në nenet 30 dhe 32, pika 2, të Kushtetutës,* pasi kërkuesi është deklaruar fajtor pa faj dhe në kundërshtim me faktet dhe provat, për veprime të cilat nuk përbëjnë fakt penal. Referuar procedurave të parashikuara në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe kompetencave të administratorit, të parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" *(ligji nr. 9901/2008)*, në raportin mes kërkuesit dhe ekonomistit të shoqërisë dhe nga tërësia e veprimeve mes tyre nuk plotësohet as ana subjektive, as ana objektive e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", të parashikuar në nenin 186 të KP-së. Po kështu, kërkuesi është akuzuar dhe dënuar njëkohësisht edhe për veprat penale "Shpërdorimi i kompetencave" dhe "Mashtrimi", të parashikuara përkatësisht nga nenet 164 dhe 143, paragrafi i dytë, të KP-së, dy vepra penale të cilat, referuar nocionit dhe anës objektive të tyre, nuk mund të bashkekzistojnë. Akuza për veprën penale "Shpërdorimi i kompetencave" nuk i referohet asnjërës prej

kompetencave të administratorit, të parashikuara në ligjin nr. 9901/2008. Ndërsa për akuzën e veprës penale "Mashtrimi", vlerësimi i pasojës (si pjesë e anës objektive të kësaj vepre penale) është bazuar në një ekspertizë me gabime matematikore, në referim të dokumentacionit të gabuar, në kundërshtim me faktet dhe provat, si dhe pa një analizë të logjikës ekonomike.

7.2 *Parimin e mosdiskriminimit dhe të mosdënimit pa ligj, për shkak të moszbatimit të ligjit penal favorizues dhe të fuqisë prapavepruese të tij, si dhe standardin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur, të parashikuara në nenet 18, 29 dhe 42 të Kushtetutës,* pasi Gjykata e Lartë e ka diskriminuar kërkuesin në raport me personat e tjerë të cilët janë dënuar pas tij sipas ligjit të ri favorizues, duke përfituar masa më të lehta dënimi. Sipas ligjit të kohës, kur është shpallur vendimi i gjykatës së apelit, vepra penale "Mashtrimi", e parashikuar në nenin 143, paragrafi i dytë, të KP-së, dënohej me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet, ndërsa me ndryshimin që pësoi kjo dispozitë me ligjin nr. 36/2017, masa e dënimit ndryshoi nga dy gjer në gjashtë vjet. Gjykata e Lartë duhej ta kishte kthyer çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, pasi në rrethanat kur vendimi, ndaj të cilit ishte paraqitur rekurs, nuk ishte ekzekutuar ende, ajo nuk mund ta zgjidhte çështjen për shkak të zbatimit të ligjit të ri favorizues.

7.3 *Parimin e hierarkisë së akteve normative, të parashikuar në nenet 116 dhe 122 të Kushtetutës,* sepse Kolegji Penal është bazuar në vendimin nr. 4, datë 27.3.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili e kufizon zbatimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues deri në momentin kur vendimi i dënimit ka marrë formë të prerë, interpretim që bie ndesh me nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 7 të KEDNJ-së. Zbatimi i ligjit të ri favorizues nuk kufizohet nga ecuria e procedimit penal deri në ndonjë fazë të caktuar dhe vendimi i Kolegjeve të Bashkuara është në kundërshtim edhe me parimin e barazisë përpara ligjit, pasi shkaktohet diskriminim i padrejtë dhe i pajustifikuar nga ndonjë interes i lartë publik, çka bie në kundërshtim me kriteret e parashikuara në nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës.

7.4 *Standardin e arsyetimit të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e ankimit efektiv, të parashikuara në nenet 17, 42, 43 dhe 142 të Kushtetutës,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar në vendim për pretendimet thelbësore të kërkuesit. Nëse do t'i kishte vlerësuar me paanshmëri faktet dhe pretendimet, pavarësisht se si janë formuluar, bazuar në parimin *iura novit curia*, ajo duhej ta kishte përcaktuar vetë shkakun e rekursit, si dhe duhet të kishte dhënë përgjigje për pretendimet e natyrës thelbësore për zgjidhjen e çështjes, në përputhje me nenet 42 dhe 142 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Mungesa e arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Lartë është e pajustifikuar, për rrjedhojë kërkuesit nuk i është siguruar as aksesi efektiv në gjykatë.

7.5 *Të drejtën për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, të parashikuar nga nenet 31, 33 dhe 42 të Kushtetutës,* pasi kërkuesit nuk i është dhënë mundësia dhe koha e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen, duke qenë se ai nuk është njoftuar për trupin gjykues, datën dhe orën e seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë. Në dosjen gjyqësore të kësaj gjykate mungon dokumentacioni që provon caktimin e çështjes me short, njoftimi dhe afishimi i të dhënave të çështjes në faqen zyrtare të gjykatës, me qëllim marrjen dijeni për to nga kërkuesi, mbrojtësi dhe publiku, si dhe procesverbali i seancës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi.

8. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në parashtrimet drejtuar Gjykatës, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke argumentuar se:

8.1 Ndryshimet në nenet 431 dhe 434 të KPP-së, sipas ligjit nr. 35/2017, kanë përcaktuar kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, kurse në nenin 432 të KPP-së janë parashikuar shkaqet për të cilat mund të bëhet rekurs. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me të drejtë ka vlerësuar në rastin konkret se nuk ka shkaqe për të cenuar vendimet e gjykatave më të ulëta, pasi asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nuk u referohet shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Pjesa e pretendimeve në rekurs që lidhet me vlerësimin e provave del jashtë juridiksionit të Gjykatës së Lartë, e cila në të gjitha rastet vendos mospranimin e tij.

8.2 Për sa i përket pretendimit për moszbatimin e ligjit penal favorizues, sipas nenit 29 të Kushtetutës, ndryshimi i cilësimit juridik nuk mund të bëhej nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë pas ndryshimeve të KPP-së. Ndonëse kërkuesi kishte paraqitur rekurs në atë gjykatë, ai nuk ka ngritur pretendime për zbatimin e ligjit penal favorizues, çka mund të zgjidhet gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal.

8.3 Në lidhje me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit dhe të së drejtës së aksesit, Gjykata e Lartë, edhe pse përmes një arsyetimi të kufizuar, ka konfirmuar ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të ankimuara, pra mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe atij procedural penal nga gjykatat më të ulëta. Në rastin konkret nuk rezulton të jetë cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

**III**
**Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese**

*A. Për legjitimimin e kërkuesit*

9. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatën Kushtetuese dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Për sa i përket *shterimit të mjeteve juridike efektive,* bazuar në parashikimet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata konstaton se objekt i këtij ankimi kushtetues individual është vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, nga materialet bashkëlidhur kërkesës, rezulton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar nga kërkuesi është ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i datës 21.9.2021, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 19.1.2022. Për rrjedhojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

13. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata konstaton se kërkuesi ka parashtruar një sërë pretendimesh, si dënimin pa faj dhe në kundërshtim me faktet dhe provat në gjykim, si dhe cenimin e parimit të mosdiskriminimit dhe të mosdënimit pa ligj, për shkak të moszbatimit të ligjit penal favorizues dhe fuqisë prapavepruese të tij, të standardit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur, të standardit të arsyetimit të vendimit, të së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj, të së drejtës së ankimit efektiv dhe të së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar përpara se të gjykohet. Gjykata vlerëson se këto pretendime janë me natyrë kushtetuese, për rrjedhojë, nisur nga thelbi i tyre, ato do të merren në shqyrtim prej saj në vijim dhe do të analizohen në këndvështrim të së drejtës së aksesit në gjykatë, të lidhur me të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën e ankimit efektiv, si dhe të parimit të arsyetimit të vendimit, të lidhur me parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues.

*B. Për themelin e pretendimeve*

*B.1. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit, të lidhur me të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën e ankimit efektiv*

14. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar në gjykim, si dhe drejtën për ankim efektiv. Sipas tij, Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për përbërjen e kolegjit që do të shqyrtonte rekursin, për procedurën e shqyrtimit të tij, për datën dhe orën e seancës, në përputhje me nenin 436 të KPP-së, si dhe nuk ka publikuar të dhënat e çështjes në faqen zyrtare. Në dosjen gjyqësore të asaj gjykate mungon dokumentacioni që provon caktimin e çështjes me short, njoftimi dhe afishimi i të dhënave të çështjes në faqen zyrtare të gjykatës, me qëllim marrjen dijeni për to nga kërkuesi,

mbrojtësi dhe publiku, si dhe procesverbali i seancës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi.

15. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen brenda kufijve të juridiksionit të saj si gjykatë ligji. Kolegji Penal me të drejtë ka vlerësuar se nuk ka shkaqe për të cenuar vendimet e gjykatave më të ulëta, pasi asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nuk u referohet shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së dhe ajo pjesë që lidhet me vlerësimin e provave del jashtë juridiksionit të Gjykatës së Lartë. Edhe pse përmes një arsyetimi të kufizuar, ajo gjykatë ka konfirmuar ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të ankimuara, pra mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe atij procedural penal nga gjykatat më të ulëta.

16. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e gjykimit të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik *(shih vendimin nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Në lidhje me të drejtën e aksesit, si element i së drejtës për proces të rregullt, Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës *(shih vendimet nr. 12 datë 9.3.2021; nr. 21, datë 20.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

19. Për sa i përket së drejtës së mbrojtjes në procesin penal, si një nga elementet thelbësore për një proces të drejtë, Gjykata ka theksuar se ajo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për seancën, si dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij *(shih vendimin nr. 14, datë 21.6.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në jurisprudencën kushtetuese janë përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit *(shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 37, datë 30.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata ritheksonse kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor dhe se marrja e vendimit për çështje kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 39, datë 5.5.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se në listën e dokumenteve të dosjes gjyqësore, që i përket gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, nuk rezulton ndonjë njoftim në lidhje me çështjen e kërkuesit. Për rrjedhojë, me qëllim verifikimin e

këtij pretendimi të kërkuesit, për mosnjoftimin e tij për përbërjen e kolegjit të caktuar për shqyrtim, për procedurën, si dhe për datën dhe orën e seancës, iu kërkua Gjykatës së Lartë informacion për procedurat e ndjekura në lidhje me këtë çështje. Kancelari i Gjykatës së Lartë, me shkresën nr. 836/1 prot., datë 15.3.2022, ka informuar Gjykatën se çështja e kërkuesit është regjistruar në datën 1.2.2016 dhe (si në të gjitha rastet) është shortuar automatikisht te gjyqtari/relator përkatës, emri i të cilit është publikuar në faqen zyrtare. Sipas kësaj shkrese: *"për këtë çështje nuk ka pasur planifikim date për shqyrtimin e rekursit përpara afatit 30 ditë dhe as procesverbal të mbajtur në dhomë këshillimi."*. Megjithatë, edhe pse u kërkua informacion për aktet e njoftimit, dokumentet bashkëlidhur kanë të bëjnë vetëm me mënyrën e caktimit të gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykues dhe të shortimit të çështjeve penale. Po ashtu, nga verifikimi në faqen elektronike zyrtare të Gjykatës së Lartë, çështja e kërkuesit ka statusin "mbyllur" dhe shfaqet në tabelën e çështjeve penale për shqyrtim në dhomën e këshillimit të Kolegjit Penal të datës 21 shtator 2021.

21. Gjykata vëren se sipas rregullave të përgjithshme procedurale për ankimin (nenet 407 e vijues të KPP-së), Gjykata e Lartë duhet të kryejë disa veprime paraprake përpara se të gjykojë çështjen, konkretisht: caktimi i kolegjeve përkatëse për shqyrtimin e rekurseve nga kryetari i kësaj gjykate, caktimi i datës për shqyrtimin e rekursit nga kryetari i kolegjit, njoftimi i palëve për datën dhe orën e gjykimit, të paktën 30 ditë përpara, nga sekretaria e gjykatës, nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara ose të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa.

22. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se sekretaria e Gjykatës së Lartë nuk rezulton të ketë kryer njoftimin e kërkuesit dhe as të mbrojtësit të caktuar prej tij, me asnjë nga mënyrat e parashikuara në ligj. Për rrjedhojë, kërkuesi, duke mos u njoftuar në përputhje me dispozitat procedurale për datën e shqyrtimit të rekursit së tij, nuk ka pasur mundësi të paraqesë pretendimet e tij për zbatimin e ligjit penal favorizues, të cilat nuk mund të ishin paraqitur prej tij në momentin e paraqitjes së rekursit. Nga ana tjetër, Kolegji Penal nuk ka verifikuar respektimin e procedurave të njoftimit, për rrjedhojë arsyetimin e vendimit e ka bazuar vetëm mbi shkaqet e rekursit, sipas formulimit të tyre në momentin e paraqitjes së tij nga avokati i kërkuesit. Në këtë mënyrë, duke mos e njoftuar për datën e shqyrtimit të rekursit e ka vënë në pamundësi të paraqesë pretendimet e tij në lidhje me çështje të zbatimit dhe veprimit të ligjit në kohë, duke i kufizuar në këtë mënyrë aksesin substancial në gjykim, për më tepër që ligji penal në kohën e shqyrtimit të rekursit kishte pësuar ndryshime.

23. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit, i parë së bashku me të drejtën e ankimit efektiv dhe atë për t'u mbrojtur, është i bazuar.

*B.2. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit, të lidhur me parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues*

24. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues me efekt prapaveprues, pasi nuk ka marrë parasysh faktin që gjatë kohës që çështja ndodhej për shqyrtim në Kolegjin Penal, ligji nr. 36/2017 ndryshoi masën e dënimit për veprën penale "Mashtrimi", të parashikuar nga neni 143 i KP-së, një nga veprat penale për të cilat është dënuar. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë e ka diskriminuar në raport me persona të tjerë, të cilët janë dënuar pas tij në bazë të ligjit të ri favorizues, duke përfituar masa më të lehta dënimi.

25. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se ndryshimi i cilësimit juridik nuk mund të bëhej nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pas ndryshimeve të KPP-së me ligjin nr. 35/2017, ndonëse për çështjen e tij kërkuesi kishte paraqitur rekurs në këtë Gjykatë. Në rekurs nuk është ngritur pretendimi për zbatimin e ligjit penal favorizues, çka mund të zgjidhet gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal të dhënë ndaj tij.

26. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimin nr. 10, datë 4.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Vendimi

gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre *(shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese).* Në aspektin e kontrollit kushtetues Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar *(shih vendimet nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Gjykata rithekson se e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, e sanksionuar në nenin 29, pika 3, të Kushtetutës, është një parim themelor që ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe, si i tillë, është i rëndësishëm për respektimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 17.4.2007; nr. 35, datë 20.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese).* Neni 29 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj; se nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale; se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Kjo dispozitë kushtetuese reflektohet edhe në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit askush nuk mund të dënohet për një vepër që sipas ligjit të kohës kur është kryer nuk përbënte vepër penale; ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese; kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale *(shih vendimet nr. 12, datë 15.2.2017; nr. 1, datë 20.1.2014, të Gjykatës Kushtetuese).*

28. Duke u rikthyer në çështjen konkrete, Gjykata vëren se në vendim Kolegji Penal ka vlerësuar vetëm shkaqet e rekursit, ashtu sikurse kanë qenë të formuluara në momentin e paraqitjes së tyre nga avokati i kërkuesit, për të cilat është shprehur se lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal, nenit 152 të KPP-së, nga ana e gjykatës së apelit, e lidhur kjo me vlerësimin e provave të marra e të verifikuara në këtë gjykim, të cilat dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj *(shih paragrafët 12 dhe 13 të vendimit nr. 00-2021-713, datë 21.9.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).* Në këtë vendim Kolegji Penal nuk ka vlerësuar ndryshimet që kishte pësuar ndërkohë neni 143 i KP-së nga ligji nr. 36/2017 dhe efektet e këtij ndryshimi në çështjen konkrete.

29. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë qëndrim të konsoliduar se, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion për më tepër i Gjykatës së Lartë. Me ndryshimet e reja kushtetuese, neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Gjykata e Lartë i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta kryer vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimin nr. 4, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta *(shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 17.4.2007; nr. 35, datë 20.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese).*

30. Bazuar në sa më sipër, duke qenë se në rastin konkret çështja ishte ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe dënimi penal i dhënë ndaj kërkuesit lidhej drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit të shfuqizuar (neni 143 i KP-së), Gjykata çmon se ky ndryshim i ligjit penal duhej të ishte arsyetuar nga Gjykata e Lartë nëse bënte të aplikueshëm zbatimin e ligjit penal favorizues. Për rrjedhojë, në kushtet kur në kohën e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë kishte ndryshuar ligji penal, ajo duhej të ishte shprehur për zbatimin e garancive kushtetuese dhe procedurale ndaj kërkuesit.

31. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të bazuara dhe duhet të pranohen sipas arsyetimit të mësipërm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000,

"Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-713, datë 21.9.2021, të Gjykatës së Lartë si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
4. Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 22.9.2022.
Shpallur më 19.10.2022.

Kryetare: Vitore Tusha
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Altin Binaj, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci

## VENDIM
## PËR REZULTATIN E ZGJEDHJEVE DHE SHPALLJEN E FITUESVE

Në mbështetje të nenit 115, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", dhe nenit 15, të rregullores nr. 3152/5, datë 11.12.2018, "Për procesin e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit dhe për procesin e votimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë", Komisioni i Votimit, me përbërje:

Alma Muça kryetare;
Thoma Jano anëtar;
Alfred Progonati anëtar,

pas administroi gjithë dokumentacionin e votimit, numëroi votat, përpiloi procesverbalin përkatës,

VËREN:

Në përfundim të procesit të votimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve për zgjedhjen e një anëtari prokuror për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kandidatët sipas numrit më të madh të votave të vlefshme, renditen në mënyrën si vijon:

I. Për anëtar prokuror në Këshillin e Lartë të Prokurorisë:
z. Etien Kapo 83 vota
znj. Ledina Riza 115 vota

II. Për anëtar prokuror në Këshillin Drejtues të Magjistraturës:
z. Albert Kuliçi 100 vota
z. Arqilea Koça 76 vota
znj. Elona Alvora 20 vota

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenin 115, paragrafët 5 e 7, dhe 247, pika 1, shkronja "d", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe nenit 15, të rregullores së Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, Komisioni,

VENDOSI:

1. Të shpallë fitues si anëtar prokuror në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;
Znj. Ledina Riza
2. Të shpallë fitues si anëtar prokuror në Këshillin Drejtues të Magjistraturës:
Z. Albert Kuliçi
3. Ky vendim të shpallet zyrtarisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme.
4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më datë 25.10.2022 , ora 13:12

KOMISIONI I VOTIMIT
**Kryetare: Alma Muça**
**Anëtarë: Thoma Jano, Alfred Progonati**

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 142
Datë: 2022/10/28 13:03:02
532a858f-afe9-4fe3-9103-e822a6ab1f6c

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë